



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

Nr. 127 Prot.

Tiranë, më 06/09/2021

**V E N D I M**

**Nr. 1, datë 06/09/2021**

**P Ë R**

**HAPJEN E PROCESIT TË KANDIDIMIT PËR DISA VENDE VAKANTE PËR  
ANËTARË DHE SEKRETARË TË KOMISIONEVE TË ZGJEDHJEVE NË  
FAKULTETE (KZF)**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës", neni 6 dhe neni 7, urdhrin nr. 36, datë 28.07.2021 të Rektorit "Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe përcaktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve të pjeshme në Universitetin Politeknik të Tiranës", në mbledhjen e datës 06.09.2021 Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

**V E N D O S I:**

1. Hapjen e procesit të kandidimit për disa vende vakante për anëtarë dhe sekretarë të Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF).
2. Kandidatët për anëtarë dhe sekretarë të KZF – ve vetëkandidohen pranë sekretarisë së KIZ.
3. Formulari i vetëkandidimit për anëtarë dhe sekretarë të KZF-ve plotësohet pranë sekretarisë së KIZ.
4. Kandidatët përfaqësues të studentëve, duhet të paraqesin vërtetimin që ndjekin studimet në Universitetin Politeknik të Tiranës.
5. Numri i vendeve vakante për çdo njësi kryesore është si më poshtë:
  - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit 1 anëtar (përfaqësues i studentëve);

- Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës 1 anëtar (përfaqësues i studentëve);
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike 1 anëtar (përfaqësues i studentëve);
- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike 1 sekretar;
- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit akademik dhe 1 përfaqësues i studentëve); 2 anëtarë (1 përfaqësues i personelit

6. Afati i vetëkandidimit të kandidatëve për anëtarë të KZF – ve, fillon ditën e martë datë 07.09.2021 dhe përfundon ditën e mërkurë, datë 08.09.2021, ora 16:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Gjergji Islami	Kryetar	
Lindita Dhamo	Anëtar	
Albina Basholli	Anëtar	
Albana Hasimi	Anëtar	
Spartak Kuçaj	Anëtar	
Blerina Kolgjini	Anëtar	
Anjeza Gjini	Anëtar	
Nelda Kote	Anëtar	
Ergys Meda	Anëtar	



Donika Qafa

Sekretare

